



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

Dep. 06 Mr. Prof. 821/23
Dep. Nri. Prof. 02
Nri. Prof. 02-05/2023

LABORAMUS ETHICUM
SINE CORRUPTIONE

DATE/A:	27.04.2023
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-712/23
PËR/ZA/TO:	Sebahate Krasniqi, Anëtare bordit në Ndërmarrjen Publike “Posta e Kosovës” Sh.A
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad Ejupi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për shqyrtimin e rastit të konfliktit të interesit



E nderuara znj. Krasniqi,

Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Agjencia në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të saj ligjore, ofron këshillim për zyrtarët të lartë të veçantë, udhëheqësve, institucioneve udhëheqëse, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, përfshirë këshillime të veçanta për personat zyrtarë sipas këtij ligji pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme në institucionet punëdhënëse dhe kur gjykohet e domosdoshme përfshirja e Agjencisë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të denoncimit nga jashtë (raportues i rastit) ka filluar procedurën e shqyrtimit të konfliktit të mundshëm të interesit, lidhur me pretendimet si në vijim;

Sebahate Krasniqi, është Zyrtare e Komitetit të Auditimit në “Postën e Kosovës” Sh.A, në të njëjtën kohë znj. Krasniqi është edhe Udhëheqëse e Departamentit Ligjor në Institutin IKAF (Shoqatë e specializuar për auditorë të jashtëm, kontabilistë, auditorë të brendshëm dhe vlerësues). Institutin IKAF e Udhëheq Bujar Krasniqi – me të cilin ka lidhje familjare (bashkëshorti).

“Në pretendim specifikisht thuhet se; a ka konflikt interesi në rast se një zyrtar i një ndërmarrje publike mbanë pozitë me orar të plotë në ndërmarrje publike si dhe udhëheqëse e departamentit ligjor në një institut ku trajnohet zyrtarët e kësaj ndërmarrje”.

Agjencia, lidhur me këtë rast ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin relevant nga Ndërmarrja Publike "Posta e Kosovës" Sh.A.

Zyrtarja e lartë znj. Sebahate Krasniqi, është emëruar Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike "Posta e Kosovës" Sh.A, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 06/56 të datës 26.01.2022.

Zyrtarja e lartë znj. Krasniqi, duke qenë Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike "Posta e Kosovës" Sh.A, është edhe pjesë e komisionit të auditimit sipas nenit 24 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në të cilin shprehimisht thuhet;

24.1 Çdo Komision i Auditimit do të përbëhet nga tre (3) drejtorë të zgjedhur. Komisioni i Auditimit caktohet nga Aksionari(ët). Së paku dy (2) anëtarë të caktuar në këtë mënyrë duhet të jenë drejtorë të cilët janë ekspert, ose së paku kanë njohuri adekuate në kontabilitet. Anëtari i tretë do të jetë një drejtor tjetër, përveç KE-së ose kryesuesit.

24.2 Komisioni i Auditimit do të vërtetojë nëse veprimtaria dhe punët e NP-së janë duke u ushtruar në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme, dhe ekskluzivisht në interes të Aksionarit(ëve).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstaton se ushtrimi i funksionit Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike "Posta e Kosovës" Sh.A, dhe njëkohësisht Udhëheqëse e Departamentit ligjor në Institutin IKAF, nuk është në kundërshtim me Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të interesit. Përfaqësues i Autorizuar – Drejtor i Institutit IKAF është B.K.

Nga informacionet e pranuar nga Ndërmarrja Publike "Posta e Kosovës" Sh.A, sqarohet se një zyrtar nga "Posta e Kosovës" ka mbajtur trajnim në IKAF, e që trajnimi është mbajtur për zyrtar të auditimit. Ndërsa për trajnimet e tilla planifikohen me qëllim të edukimit të vazhdueshëm profesional për zyrtarët e fushës, në Institutet të cilat janë të Çertifikuara. Trajnime të tilla zyrtarët e Postës kanë mbajtur edhe në SHKÇAK. Institutet shpallin trajnimet e fushës. IKAF dhe SHKÇAK publikojnë trajnime të organizuara në vazhdimësi dhe në bazë të trajnimit anëtari apo punonjësi e vlerëson nevojën për atë trajnim dhe aplikon. Ndërmarrja planifikon buxhetin për trajnimet vjetore për punonjësit e vetë.

Ndërmarrja Publike Publike "Posta e Kosovës" Sh.A, nuk ka marrëdhënie kontraktuale me Institutin për Kontabilitet, Auditim dhe Financa.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave dhe informacioneve të rastit, konstaton se mbajtja e trajnimit nga zyrtari i postës së Kosovës në IKAF, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit sepse Ligji nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nuk ka përcaktuar rregulla kufizime lidhur me këtë situatë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ju falënderon për bashkëpunimin.